REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr.1505 Regj.
Nr 1505/4 Prot.

Tiranë, më 24/08/2022

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT Nr. 21839 Prot. Datë 25 08 2022

URDHËR

"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Për dijeni: INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT
Adresa: Tiranë

Pranë Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Privat **"JUS" sh.p.k** me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër Regj **1505** me palë:

Kreditor: INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT
Debitor: G.P.G COMPANY NIPT: J64324443V
Objekti: Pagim Gjobe

Une përmbaruesi gjyqësor Mario Hasanlliu pasi shqyrtova materialin e plotë të dosjes përmbarimore:

KONSTATOVA:

Në titullin ekzekutiv : **Vendim dënimi me gjobë Nr. 143 datë 12.07.2021 të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit,** është përcaktuar detyrimi juaj si palë debitore të paguani shumën totale të detyrimit në favor të palës kreditore **Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit,** për dënimin me gjobë, në vlerën **1.000.000 lekë**, si dhe kamatëvonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjobën e pashlyer të përllogaritur nga **Inspektorati Kombetar i Mbrojtjes së Territorit** në vlerën **600.000 lekë.** Tarifa përmbarimore për shumën totale të detyrimit është në vlerën **192.000 lekë me TVSH**

Për këtë titull ekzekutiv është lëshuar **Urdhrit te Ekzekutimit: Vendimi nr. 991 datë 13.05.2022 i Gjykates Administrative Shkalle e Pare Tiranë**

Për ekzekutim të vendimit gjyqësor të mësipërm pala debitore është lajmëruar që detyrimin ta përmbushë në mënyrë vullnetare me shkresën nr. 1505/1 prot datë 08.08.2022. Afati i ekzekutimit në mënyrë vullnetare ka kaluar por pala debitore nuk ka dokumentuar asnjë veprim për ekzekutim të këtij titulli ekzekutiv

Më datë 24/08/2022 në bazë të nenit **519 te K.Pr.Civile** nga ana e jonë është marë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrushëm duke vendosur masën e sekuestros mbi llogarinë e palës debitore në masën e detyrimit.

Rruga e Barrikadave, Pall. Perballe gjimnazit Sami Frasheri, H 31, Kati 4,Ap 14, *Cel +355 69 4000 210 ,e-mail:jus.shpk @gmail.com*

Për këtë arsye :

Në bazë të neneve **527, 593 e në vijim të K.Pr.Civile e U. B. Sh** "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e e llogarive në Banka"

U R D H Ë R O J :

1. **Qendra Kombëtare e Biznesit** brenda 10-ditësh nga marrja dijeni, të verifikojë nëse ekzistojnë kuota/aksione/aktive dhe biznese të regjistruara në emër të debitorit **G.P.G COMPANY NIPT: J64324443V** dhe nëse ka të tilla të kryejnë vendosjen e sekuestros mbi kuotat dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për shumën e detyrimit në total prej **1.792.000 (*një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë*) lekë**

2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin **598 e në vijim te K.Pr.Civile**, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Mario HASANLLIU

MARIO HASANLLIU
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Rruga e Barrikadave, Pall. Perballe gjimnazit Sami Frasheri, H 31, Kati 4,Ap 14, *Cel +355 69 4000 210 ,e-mail:jus.shpk @gmail.com*